



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Senati Akademik

Nr. 1613 Prot

Shkodër, më 13.05.2024

V E N D I M

Nr. 131 datë 13.05 2024

**"PËR MIRATIMIN E SHPËRBLIMIT PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË
UNIVERSITETIN E SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në RSH", i ndryshuar; VKM nr. 834, datë 28.12.2023 "Për një ndryshim në Vendimin nr.929, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", të ndryshuar, dhe për shtesë fondi në buxhetin e vitit 2023, miratuar për disa institucione", Vendimin e SA-së nr. 91, datë 29.03.2024, Senati akademik, duke njohur të drejtën e disa punonjësve të fituar me VKM nr. 834, datë 28.12.2023, pasi shqyrtoi vendimin e Bordit të Administrimit të USH-së nr.109, të datës 15.04.2024 "Për mosmiratimin e shpërblimit për punonjësit mbështetës në USH", në mbledhjen e datës 13.05.2024,

Vendosi

1. Të miratojë shpërblimin për punonjësit mbështetës të cilët paguhen me sistemin me 9 dhe 13 klasa në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë.
2. T'i kërkojë Bordit të Administrimit miratimin e shpërblimit për punonjësit mbështetës nga të ardhurat e institucionit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Rajmonda Këçira

